



NAMAZI

(Mësimi i faljes së namazit)



**Titulli: Namazi
(Mësimi i faljes së namazit)**

**E përktheu nga gjuha perse:
Sabrie FEZA**

**E redaktoi:
Liseda RAMAJ**

**E korrektoi:
Vjollca KARAJ**

**Recensent:
Vullnet MERJA**

**Përkujdesja kompjuterike:
Sabrie FEZA**

Botoi: Shoqata “FLLADI”

Tiranë, 2014

**www.radioehlibeji.com
www.dritaeelibejt.com**



3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e All'lahut,
të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit



“Sigurisht, namazi është
detyrë për besimtarët
në kohë të caktuar.”

(Surja “Nisa”, ajeti 103)

Hadithe

Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë:
“Namazi është ndër veprat më të mira.”



Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Falja e namazit është rruga për t'u afruar tek All'lahu.”




Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë:
“Kushdo që fal namaz, i ndriçohet zemra.”

Abdesi



Si të marrim abdes

Para se të marrim abdes,
duhet të heqim nga duart çdo
gjë e cila pengon
depërtimin e ujit në lëkurë si:
manikyri, ngjitësja, vaji etj.





Marrja e abdesit



Për të marrë abdes, në fillim lajmë duart, pastaj lajmë fytyrën nga vendi ku fillojnë flokët, deri te mjekra. Kjo kryhet një herë, duke patur parasysh që të mos mbetet asnjë gjë pa u lagur me ujë.





Pastaj, me dorën e majtë
lajmë krahun e djathtë, duke
filluar nga bërryli deri te
majat e gishtave. Kjo kryhet
një herë, duke patur parasysh
që të mos mbetet asnjë gjë
pa u lagur me ujë.




Me dorën e djathtë
lajmë krahun e majtë,
nga bërryli e deri te
majat e gishtave. Kjo
kryhet një herë, duke
patur parasysh që të
mos mbetet asnjë gjë
pa u lagur me ujë.



Më pas, fshijmë pjesën
e përparme të kokës. Kjo
fshirje duhet të bëhet me
ujin që ka mbetur në duar
prej abdesit pa i lagur ato
përsëri. Fshirja kryhet me
pëllëmbën e dorës
së djadhtë ose me majën
e gishtave të saj, duke
filluar nga mesi i kokës e
deri te fillimi i ballit.





Pastaj, po me lagështirën
e mbetur në duar, fshijmë
pjesën e sipërme
të këmbëve.

Në fillim, me dorën
e djathtë fshijmë pjesën
e sipërme të këmbës
së djathtë, duke filluar nga
majat e gishtave e deri te nyja
e këmbës.

Me dorën e majtë
fshijmë pjesën e sipërme të
këmbës së majtë, duke
filluar nga majat
e gishtave e deri te nyja e
këmbës.



Çfarë e prish abdesin?



Abdesin e prish: fjetja,
humbja e ndjenjave, kryerja
e nevojave, dalja e gazrave
etj...



Ezani

All'luhu Ekber, All'luhu Ekber,

All'luhu Ekber, All'luhu Ekber;

(All'luhu eshtë më i Madhi)

Esh'edu en la ilah il'lall'lah,

Esh'edu en la ilah il'lall'lah;

(Dëshmoj se nuk ka zot tjeter përveç
All'luhut.)

Esh'edu enne Muhammeden

Resulull'lah, Esh'edu enne

Muhammeden Resulull'lah;

(Dëshmoj se Muhammedi eshtë i Dërguari i
All'luhut.)

Esh'edu enne Alijen uelij'jull'lah,

Esh'edu enne Alijen uelij'jull'lah;

(Dëshmoj se Aliu eshtë i dashuri i All'luhut.)
(Kjo dëshmi nuk eshtë e detyrueshme, por eshtë e pëlqyeshme.)

Haj'je alas-salah,

Haj'je alas-salah;

(Eja në namaz.)

Haj'je alel felah,

Haj'je alel felah,

(Eja në shpëtim.)

Haj'je ala khajril amel,

Haj'je ala khajril amel,

(Eja në kryerjen e veprave të mira.)

All'luhu Ekber, All'luhu Ekber;

(All'luhu eshtë më i Madhi.)

La ilah il'lall'lah,

La ilah il'lall'lah,

(Nuk ka zot tjeter përveç All'luhut.)



Ikameti

All' llahu Ekber, All' llahu Ekber;

(All' llahu eshtë më i Madhi.)

Esh' hedu en la ilahe il'lall' llah,

Esh' heduen la ilahe il'lall' llah;

(Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç

All' llahut.)

Esh' hedu enne Muhammeden

Resulull' llah, Esh' hedu enne

Muhammeden Resulull' llah;

(Dëshmoj se Muhammedi eshtë i Dërguari i

All' llahut.)

Esh' hedu enne Alijen uelij' jull' llah,

Esh' hedu enne Alijen uelij' jull' llah;

(Dëshmoj se Aliu eshtë i dashuri i All' llahut.)

Haj'je alas-salah,

Haj'je alas-salah;

(Eja në namaz.)

Haj'je alel felah,

Haj'je alel felah,

(Eja në shpëtim.)

Haj'je ala khajril amel,

Haj'je ala khajril amel,

(Eja në kryerjen e veprave të mira.)

Kad kametis-salah,

Kad kametis-salah,

(Bëhuni gati për namaz.)

All' llahu Ekber, All' llahu Ekber;

(All' llahu eshtë më i Madhi.)

La ilahe il'lall' llah,

(Nuk ka zot tjetër përveç All' llahut.)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ أَرْحَمَنَ
 أَرْحَمَ مَلِكٌ يَوْمَ الدِّينِ
 إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ
 أَهْدَنَا أَصْرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ صِرَاطَ
 الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرَ الْمَغْضُوبِ
 عَلَيْهِمْ وَلَا أَصْنَاعُ لَهُمْ

Surja “Fatiha”

Bismil’lahirr Rrahmanirr Rrahiim
 El hamdu lil-lahi rab-bil alemiin;
 Err-Rrahmanirr Rrahiim;
 Maliki jeumid diin;
 Ij’jake na’budu ue ij’jake nesteiin;
 Ihdinas-siratal mustekiim;
 Siratal’ledhiine en amte alejhim;
 gajril magdubi alejhim
 ueled-daaaaliin.

Me emrin e All’llahut, tē Gjithmëshirshmit,
 Mëshirëplotit. (1)
 Lavdërimi i takon Zotit tē botëve. (2)
 Mëshiruesit, Mëshirëplotit. (3)
 Sunduesit tē Ditës së Gjykimit. (4)
 Vetëm Ty tē adhurojmë dhe vetëm prej
 Teje ndihmë kërkojmë. (5)
 Na udhëzo në rrugën e drejtë! (6)
 Në rrugën e atyre që u ke dhruuar mirësi,
 e jo tē (rrugën e) atyre që (kanë
 shkaktuar) Je zemëruar dhe as tē
 (rrugën e) atyre që janë
 tē humbur. (7)



سُورَةُ الْإِخْلَاصِ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ؕ اللَّهُ الصَّمَدُ ؕ لَمْ يَكُنْ لَّهُ
وَلَمْ يُولَدْ ؕ وَلَمْ يَكُنْ لَّهُ كُفُواً أَحَدٌ



Surja “Ikhlas” (Teuhid)

Bismil’lahirr Rrahmanirr Rrahiim
Kul hu uall’llahu e had;
All’llahus- samed;
Lem jelid ue lem juuled;
Ue lem jekul’lehu kufu’uen ehad.

Me emrin e All’llahut, të Gjithmëshirshmit,
Mëshirëplotit.

“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! (1)

Allahu është Absoluti, (2)

Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. (3)

Dhe askush nuk është i barabartë
(a i krahasueshëm) me Të!” (4)



Shehadeti

Esh'heduen la ilahe il'lall'lah
Uahdehu la sheriike leh
Ue esh'heduen'ne
Muhammeden abduhu
ue Resuluhu
All'llahume sal'li ala
Muhammed ue ali
Muhammed

Dëshmoj se nuk ka zot tjeter përveç
All'llahut;
I Vetmi që nuk ka shok;
dhe dëshmoj se vërtet, Muhammedi
është robi i Tij
dhe i Dërguari i Tij.
O All'lah, dërgo paqe pér
Muhammedin dhe familjen e tij!



Selami

Es-selamu alejke ej'juhen
nebij'ju ue rahmetull'llahi ue
berekatuhu

Es-selamu alejna ue ala
ibadil'lahis-salihiiin

Es-selamu alejkum ue
rahmetull'llahi ue berekatuhu

Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë
mbi ty, o Profet!

Paqja qoftë mbi ne dhe mbi
adhuruesit e All'llahut punëmirë!


Paqja dhe mëshira e All'llahut
qoftë mbi ju!



Si të falim namazin

E bëjmë “nijet”.

Pra, vendosim me veten tonë që
të falim namaz për kënaqësi të
All'lahut dhe themi: “All'lahu
Ekber”.




Pastaj lexojmë suret “Hamd”
(Fatiha) dhe “Teuhid” (Kul hu
uall'lahu e had).



Biem në ruku (përkulje) dhe themi: "Subhane Rabbijel adhiim ue bihamdih" ose tri herë: "Subhanall'lah".




Ngrihemë dhe qëndrojmë duke thënë: "Semiall'lahu limen hamideh".




Biem në sexhde
dhe themi:
"Subhane
Rabbijel a'la
ue bihamdih"
ose tri herë:
"Subhanall'lah".




Ngrihem i nga
sexhdja dhe
qëndrojmë ulur
e themi:
"Es-tegfirull'lah"
(ulja ndërmjet dy
sexhdeve).




Biem në sexhde
dhe themi:
"Subhane
Rabbijel a'la
ue bihamdih"
ose tri herë:
"Subhanall'lah".



Pas sexhdes së rekatit të parë, ngrihem i në këmbë për rekatin e dytë dhe këndojojmë suren “Hamd” dhe një sure tjetër, si psh. suren “Teuhid”.



Pasi kemi kënduar suret “Hamd” dhe “Teuhid”, është radha e duasë (e Kunutit).




Në kunut, duart ngrihen lart para fytyrës dhe i lutemi Zotit (me fjalët që duam në çfarëdo lloj gjuhe).




Pas kunutit, biem në ruku dhe themi: "Subhane Rabbijel adhiim ue bihamdih" ose tri herë: "Subhanall'lah".



Ngrihemë dhe qëndrojmë duke thënë: "Semiall'lahu limen hamideh".



Biem nē sexhde
dhe themi:
"Subhane
Rabbijel a'la ue
bihamdih" ose
tri herë:
"Subhanall'lah".



Ngrihemı nga
sexhdja dhe
qëndrojmë ulur
e themi:
"Es-tegfirull'lah".

Sërish, biem nē
sexhde dhe themi:
"Subhane Rabbijel
a'la ue bihamdih"
ose tri herë:
"Subhanall'lah".




Ngrihemı nga
sexhdja,
qëndrojmë ulur
dhe themi
shehadetin
(dëshminë).






Pas shehadetit, ngrihemë në
këmbë për rekatin e tretë dhe
themi tri herë: "Subhanall'lah,
uel hamdulil'lah, ue la ilahe
il'lall'lah, ue All'lahu Ekber"
ose suren "Fatiha".





Biem në ruku dhe themi:
"Subhane Rabbijel adhiim ue
bihamdihi" ose tri herë:
"Subhanall'lah".



**Ngrihemı dhe qëndrojmë
duke thënë: "Semiall'llahu
limen hamideh".**




**Biem në sexhde
dhe themi:
"Subhane Rabbijel
a'la ue bihamdih"
ose tri herë:
"Subhanall'lah".**



**Ngrihemı nga
sexhdja dhe
qëndrojmë ulur
e themi:
"Es-tegfirull'lah".**

Biem në sexhde
dhe themi:
"Subhane Rabbil
a'la ue bihamdih"
ose tri herë:
"Subhanall'lah".



Pas rekatit të tretë,
ngrihemë në këmbë
dhe fillojmë rekatin e
katërt, duke thënë tri
herë: "Subhanall'lah,
uel hamdulil'lah, ue
la ilahe il'lall'lah, ue
All'lahu Ekber" ose
suren "Fatiha".



Biem në ruku dhe
themi: "Subhane
Rabbil adhiim
ue bihamdih"
ose tri herë:
"Subhanall'lah".






Ngrihemni dhe
qëndrojmë duke
thënë:
“Semiall’llahu
limen hamideh”.



Biem në sexhde
dhe themi:
“Subhane Rabbijel
a’la ue bihamdih”
ose tri herë:
“Subhanall’lah”.



Ngrihemni nga
sexhdja dhe
qëndrojmë ulur
e themi:
“Es-tegfirull’lah”.



Biem në sexhde dhe themi:
"Subhane Rabbil a'la ue
bihamdih" ose tri herë:
"Subhanall'lah".



Ngrihem i nga sexhdja, themi
shehadetin (dëshminë) dhe japim
selam. Me dhënen
e selamit në rekatin e katërt,
mbaron namazi.



Numri i rekateve të namazeve të detyrueshme (farz):

Namazi i agimit
(sabahu):
dy rekate;

Namazi i drekës
(yleja):
katër rekate;

Namazi i mbasdites
(ikindia):
katër rekate;

Namazi i perëndimit
(akshami):
tre rekate;

Namazi i darkës
(jacia):
katër rekate.

Namazi prishet kur:



- Flasim (gjatë faljes);
- Qeshim (gjatë faljes);
- Lëvizim shumë (gjatë faljes);
- Hamë ose pimë (gjatë faljes)
etj.



Disa nga rregullat e hyrjes në namaz

Që namazi ynë të jetë i rregullt, duhet që:

- Rrobat, trupi dhe vendi ku do të biem në sexhde, të jenë të pastra;
- Namazin ta falim të drejtuar nga Kibla;
- Namazin ta falim me rrobat tona ose nëse i kemi marrë nga një person tjeter, duhet të kemi lejen e tij;
- Namazin ta falim në mjedisin ose ambientin tonë. Në të kundërt, duhet të marrim leje nga zotëruesi i ambientit, etj.





Kuptimi i shprehjeve

"Subhane Rabbijel a'la ue bihamdih"

I Lartësuar dhe i Falënderuar është Zoti, më i Larti.

"Subhane Rabbijel adhiim ue bihamdih"

I Lartësuar dhe i Falënderuar është Zoti, më i Madhi.

"Semiall'llahu limen hamidehu"

All'llahu e dëgjon atë që e lavdëron Atë.

"Es-tegfirull'llah"

Kërkoj falje nga All'llahu.

"Subhanall'llah"

I Lartësuar është All'llahu.

Shënim:

- Zanoret që janë pranë njëra-tjetrës, lexohen me dy kohë.
- Para se të biem në ruku, para se të shkojmë në sexhde dhe para se të ngrihem prej saj (sexhdes), të gjitha këto veprime, është e pëlqyeshme të shoqërohen me fjalën "All'llahu Ekber".

- Dhënia e "selamit":

- 1- Në namazin e sabahut, pas shehadetit, në rekatin e dytë, thuhet edhe selami.
- 2- Në namazin e akshamit, në rekatin e tretë, pas sexhdes së dytë, qëndrojmë ulur dhe themi shehadetin dhe japim selam.



لأول مرة في الأسواق كسلسلة تذكيرية مقدمة للحجاج في زيارة إيمان وروح وسلام



Shoqata "FLLADI"

www.dritaeehlibejtit.com

www.radioehlibejti.com